

MY PET UDHËZUES PËRDORIMI

www.telekom.com.al/mypet



SI TË AKTIVIZONI MY PET - IN TUAJ?

1. Merrni My Pet nga kutia dhe shkruani ID-në e tij me 10 shifra në një vend të sigurt.
2. Para se të vendosni kartën SIM në My Pet, ju lutemi



çaktivizoni kodin PIN dhe më pas vendosni kartën SIM në vendin e caktuar, siç tregohet në figurë. 3. Karikoni My Pet duke përdorur karikuesin USB standard 5V në kuti. Kur pajisja është duke u karikuar, shfaqet një ngjyrë jeshile e cila pulson.

Kur My Pet është karikuar plotësisht, aty do të shfaqet një

dritë e jeshile konstante. 4. Ndizni My Pet duke shtypur dhe mbajtur butonin e ndezjes, derisa pajisja të lëshojë një tingull. 5. Instaloni aplikacionin My Pet për Android ose iOS ose hyni në www.telekom.com.al/mypet

6. Krijoni llogarinë tuaj nëpërmjet aplikacionit ose në website. Ju lutemi mbani ID-në e My Pet, fjalëkalimin e llogarisë suaj dhe kodin e regjistrimit në një vend të sigurt.

SI TA KARIKONI MY PET?

Hiqni kapakun pranë butonit të ndezjes dhe do të shihni vendin ku vendoset karikuesi. Karikimi i baterisë së pajisjes vazhdon për rreth 120 minuta duke përdorur një kabllo USB standarde 5V.

Pasi të jetë karikuar pajisja, mbylleni kapakun me kujdes për të shmangur kontaktin me ujë, pluhur ose nga papastërtia duke mos lejuar futjen brenda dhe dëmtimin e pajisjes. Ju mund të përdorni karikues standard të telefonave celularë.

SI TË KRIJONI NJË LLOGARI PËR MY PET?

- Krijoni llogarinë tuaj nëpërmjet aplikacionit ose website-it www.telekom.com.al/mypet
- Vendosni adresën tuaj të email-it.
- Vendosni fjalëkalimin, me të paktën 6 karaktere.
- Konfirmoni fjalëkalimin tuaj.
- Vendosni ID-në 10 shifrore të pajisjes.
- Vendosni një emër për pajisjen.
- Kompletioni procesin e regjistrimit.

SI TË KONTROLLONI STATUSIN E MY PET?

Nëse shtypni vetëm një herë butonin e ndezjes, pajisja do të

shfaq për 3 sekonda statusin e saj:

1. Drita blu - My Pet është ndezur, por nuk ka lidhje interneti.
2. Drita e bardhë - My Pet është ndezur dhe është lidhur me internetin.
3. Drita e kuqe e ndezur - Bateria e My Pet është harxhuar.
4. Drita e gjelbër e ndezur - My Pet është duke u karikuar.
5. Drita e gjelbër e vazhdueshme - Bateria e My Pet është plotësisht e karikuar.

SI MUND TA NDALIM MY PET?

Sapo të lidhet me aplikacion, My Pet nuk mund të fiket me

anë të butonit të ndezjes. Në rast se jeni në një vend ku

My Pet duhet të fiket, ju duhet të vendsoni këtë të fundit

në modalitetin e airplane mode, Pajisja mund të kalohet në

këtë modalitet përmes aplikacionit të instaluar në smartphone-in.

Klikoni tek Settings dhe zgjidhni opsionin

“Switch device off” në pjesën e poshtme në listë.

SEKSIONI I AKTIVITETIT

My Pet ka të vendosur parametrat standarte të levizjeve dhe shpejtësisë, të cilat ju mundësojnë monitorimin e aktivitetit

në çdo orë të kafshës suaj.

A ËSHTË MY PET REZISTENT NDAJ UJIT?

My Pet NUK është rezistent ndaj ujit. Është rezistente ndaj baltës, pluhurit, lagështisë, pikave të ujit, mirëpo nuk duhet të futet në ujë.

Mos përdorni ujë ose detergjentë për ta pastruar atë. Nëse është e nevojshme, pastrojeni me një leckë të lagur. KUJDES! My Pet është rezistente ndaj pikave të ujit vetëm nëse pjesa ku vendoset karikuesi si dhe pjesa ku vendoset karta SIM janë të mbyllura shumë mirë.

Nëse pajisja është lagur, fikeni atë dhe lëreni që të thahet në një peshqir me një temperaturë dhome në një mjedis me lagështi të ulët. Prisni të paktën 24 orë përpara se ta ndizni atë ose ta karikoni sërish.

SI TË DËRGONI KOMANDAT KAFSHËS SUAJ PËRMES MY PET?

Hapni aplikacionin dhe shkoni tek “Training Menu”. Kur ti shtypni katër butonat, My Pet do të lëshojë tinguj specifik.

Duke ndjekur udhëzimet në www.telekom.com.al/mypet ju

mund të trajtoni kafshën tuaj për të ndjekur një numër të komandave, të tilla “eja”, “ulu”, “shtrihu”, “qetë” dhe të tjera.

PËRSE NUK PO MARR NJOFTIME?

Nëse keni aktivizuar njoftimet në menu Setting > Notifications në aplikacionin My Pet, por ju nuk jeni duke i marrë ato, është e mundur që telefoni juaj të mos lejojë njoftimet nga ky aplikacion i veçantë. Nëse keni një iPhone, shkoni te Settings > Notifications dhe jepni leje My Pet që të marrë njoftime. Nëse keni një telefon Android, shkoni te Settings > More > Application Manager, zgjidhni My Pet nga lista e aplikacioneve, të instaluara në telefonin tuaj dhe lejoni që të marrë njoftimet. Një arsye tjetër mund të jetë për shkak të mungesës së lidhjes së internetit.

SI MUND TA GJENI SE KU NDODHET KAFSHA JUAJ

Ikona e shfaqur në aplikacion tregon vendndodhjen e kafshës suaj në hartë në një kohë të caktuar. Historiku i Vendndodhjes tregon se ku ka qenë kafsha juaj në çdo 10 minuta brenda 30 ditëve të fundit.

Si mund të shtoj fotën e kafshës sime në aplikacion?

Shtypni ikonën e kamerës, pasi të keni shtypur atë, smartphone juaj mund të kërkojë leje në mënyrë që aplikacioni My Pet të përdorë kamerë në telefonit tuaj. Jepni leje, shkrepni një foto dhe do të shihni ndryshimin menjëherë.

A MUND TA MANAXHOJ MY PET NGA DY TELEFONA TË NDRYSHËM?


Po. Mundeni, nëse ndani emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e aplikacionit me dikë që ju i besoni.


A MUND TË MONITOROHEN MË SHUMË SE NJË PAJISJE MY PET PËRMES APLIKACIONIT NGA NJË TELEFON MOBIL?


Po, nëse i shtoni ato përmes Settings > Account Settings > Shto pajisje të re.


APLIKACIONI MY PET:

SEKSIONI I VENDNDODHJES

 Seksioni Vendndodhja tregon pozicionin e My Pet në hartën, i përcaktuar nëpërmjet GPS, përmes antenave të operatorëve celularë ose rrjetit WiFi. Nëse është aktivizuar funksioni i vendndodhjes së celularit tuaj mund të tregojë edhe atë.

 **GPRS sinjal** - tregon forcën e sinjalit të rrjetit celularë Bateria e My Pet tregon gjendjen e baterisë së pajisjes në një moment të caktuar.


 **Lokalizimi GPS/GSM** - tregon llojin e teknologjisë të përdorur aktualisht për përcaktimin e vendndodhjes momentale të My Pet. Nëse sinjali GPS është i disponueshëm, tregon numrin e satelitëve të përdorur për të përcaktuar vendndodhjen e My Pet.

 **Shpejtësia** - tregon a është në lëvizje në atë çast kafsha juaj dhe sa është shpejtësia e lëvizjes.

SEKSIONI I HISTORISË SË VENDNDODHJES

 Tregon vendndodhjet konkrete të My Pet që janë regjistruar sot, ose gjatë 30 ditëve të kaluara me kohën e saktë për çdo


lëvizje veçmas

 Tregon vendet e veçanta të My Pet. Kur shtypet, ajo bëhet e kuqe dhe mbledh vende të afërta në një grup.

 Riprodhon itinerarin e My Pet në kohë. Kur klikohet dy herë ajo rrit 2-3 herë më shpejtë itinerarin e riprodhimit.

Zona e Sigurisë: Ju mund të caktoni dy zona të sigurisë. Kur aktivizoni ndonjë prej tyre për herë të parë ju do të shihni një hartë me një perimetër. Vendosni hartën nën rreth për të shënuar zonën e dëshiruar. Ju mund të ndryshoni (të zmadhoni ose të zvogëloni) perimetrin e zonës së sigurisë. Shtypni “Vazhdo” që të përcaktoni “kohën aktive të zonës”, duke shënuar orën që fillon dhe orën që mbaron, që mendoni se kafsha juaj do të jetë në këtë zonë. Pasi të shtypni “Gati” zona e sigurisë e caktuar prej jush do të aktivizohet. Ju mund të aktivizoni dhe të anuloni zonat përkatëse të sigurisë. Nëse kafsha juaj del nga zona e sigurisë derisa ajo është aktive do të merrni njoftim.


FUNKSIONI GJEJ MY PET

 Nëse My Pet ka humbur ose është hequr, dhe nuk e dini se ku

është, nëpërmjet këtij funksioni në aplikacion mund ta gjeni atë.

Klikoni ikonën në anën e djathtë nga emri i kafshës suaj, shtypni butonin “Ring” dhe My Pet do të fillojë të lëshojë një tingull, e cila do t’ju ndihmojë ta gjeni atë.

REGJISTRI I NGJARJEVE.


 Kjo menu është informative dhe tregon 100 ngjarjet e fundit me datë dhe kohë të caktuar.


MENUJA SETTINGS.


Zgjidhni gjuhën e Konfigurimeve - këtu ju mund të ndryshoni gjuhën aplikacionit My Pet.


Konfigurimet e llogarisë - këtu ju mund të shihni emrin tuaj të përdoruesit si dhe të ndryshoni fjalëkalimin. Këtu mund të shtoni një tjetër pajisje My Pet, në rast se keni më shumë se një kafshë. Nga e njejta menu ju gjithashtu mund të hiqni pajisjen My Pet nga llogaria juaj ose ta fshini atë.


Njoftime - këtu ju mund të përcaktoni llojin e njoftimeve që dëshironi të merrni.

 Dalja nga Llogaria - shërben për dalje nga llogaria e regjistruar në aplikacion.

 Informacione për My Pet - Në këtë menu mund të shikoni ID-në dhe të ndryshoni emrin dhe numrin e telefonit (në rast të ndërrimit të numrit).

 Funksioni Gjej My Pet Njoftimet me email - këtu mund të përcaktoni se për çfarë lloj ngjarje dëshironi të njoftoheni me email, në email adresën e regjistruar në llogarinë tuaj.

 Fikja e Pajisjes - këtu ju mund ta fikni pajisjen My Pet përmes aplikacionit në celularin tuaj.

 Rikthe në gjendjen fillestare - këtu ju mund të fshini të gjitha të dhënat e përcaktuara nga përdoruesi.

Ricikloni për një mjedis më të pastër!

